



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



INSTITUTI I EKONOMIËS DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE
INSTITUT ZA EKONOMIJU I JAVNE ADMINISTRACIJE
ECONOMY INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

Ligji i ri i Prokurimit Publik Nr.05/L-092

Moduli i parë :

Ligji i Prokurimit Publik, Nr.04/L-042

me Plotësim dhe Ndryshimi te

LPP Nr. 04/L-237.

LPP Nr. 05/L-068

LPP Nr. 05/L-092

Objektiva e trajnimit

Qëllimi i trajnimit është:

a) Qe te kemi një **pasqyre te përgjithshme** te ndryshimeve te Ligjit te RI te Prokurimit Publik

b) **Temat:**

- ✓ Ndryshimet kryesore në Ligjin e ri - *Analize e detajuar e LPP Nr. 05/L -068*
- ✓ Ndryshimet ne mes te këtij ligji 05/L-068 dhe ligjit 05/L-092
- ✓ Përvoja pozitive dhe negative (mësimet e nxjerra) - *Të kuptuarit e amandamentimeve të Ligjit.*

LIGJI Nr. 05/L -068

- **Ligji i ri për Prokurim Publik, LIGJI Nr. 05/L - 068**, është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më **14 Dhjetor 2015**
- Është shpallur me dekretin Nr. DL-041-2015, datë 29.12.2015, nga Presidentja e Republikës së Kosovës
- Eshtë publikuar ne Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datën **06.01.2016**
- Në bazë të Nenit 70 të këtij Ligji, parashihet që ky ligj të hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Hyn ne fuqi me datën **21.01.2016**

Aprovimi dhe publikimi ne gazeten Zyrtare

Ligji Nr ,04/L-042 është ndryshuar dhe amandamentuar edhe me Ligjin Nr. 05/L - 092, i cili është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 shkurt 2016.

Ligji i ri për Prokurim Publik, LIGJI Nr. 05/L - 092, është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 shkurt 2015

Është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-002-2016, të datës 01.03.2016 nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datën 01.03.2016.

Është në fuqi me datën 01.03.2016 .

Neni 3

Përfundimet

- Me ligjin e vjetër nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktues që të veprojë në përputhje me ndonjë procedurë të veçantë të prokurimit apo të respektoj dispozitat e LPP nëse Qeveria ka aprovuar kërkesën e Autoriteti Kontraktues për arsye se:
 - ✓ **ekzekutimi i kontratës kërkonte përdorimin e masave të veçanta të sigurisë, ose**
 - ✓ **qeveria ka klasifikuar lëndën e kontratës në fjalë si sekret.**
- KE ka një Direktive të veçantë të që rregullon kontratat e prokurimit publik në fushën e Mbrojtjes dhe sigurisë, Direktiva nr. **2009/81/EC**
- **Ne mënyrë që LPP të jete në përputhje me Direktivën e BE-se, në LPP e RI është fshire paragrafi 1 dhe janë shtuar 4 paragrafë. Me këto ndryshime janë qartësuar rastet kur zbatohet dhe kur nuk zbatohet LPP në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.**

Neni 3

Përjashtimet (2)

1. **Neni 1 përcakton se LPP aplikohet** për kontratat e prokurimit publik, të shpërblyera nga autoritetet kontraktuese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

2. **Neni 2 përcakton se LPP nuk aplikohet për:**
 - Furnizim me pajisje ushtarake,
 - Furnizimin e pajisjeve të ndjeshme ,
 - Punët, furnizimet dhe shërbimet e ndërlidhura me këto furnizime,
 - Punët dhe shërbimet për qëllime specifike ushtarake, dhe
 - Punët dhe shërbime të ndjeshme.

Për këto aktivitete zbatohet Rregullorja mbi prokurimin për këto raste e cila rregullore miratohet nga Qeveria e Kosovës.

Neni 3

Përjashtimet (3)

Neni 3 përcakton se LPP dhe as Rregulloja **nuk aplikohen për:**

1. Kontratat që rregullohen me rregullat e veçanta të prokurimit, **në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare**
2. Kontratat që rregullohen me rregulla të veçanta të prokurimit **sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare lidhur me stacionimin e trupave ushtarake të Republikës së Kosovës**
3. Kontratat që rregullohen me rregullat e veçanta të prokurimit **të një organizate ndërkombëtare që blen për qëllimet e veta**
4. Kontratat për të cilat aplikimi i dispozitave të LPP ose të rregullores **do të detyrojë Republikën e Kosovës për të dhënë informacion, zbulimi i të cilave është në kundërshtim me interesat thelbësore të sigurisë së tij**
5. Kontratat për **qëllimet e organeve që kanë të bëjnë me sistemin e inteligjencës**
6. Kontratat e dhëna në kuadër të **programit të bashkëpunimit, bazuar në kërkim dhe zhvillim.**

Neni 3

Përrjashtimet (4)

7. Kontratat e dhëna në një vend të tretë, përfshirë edhe për qëllime civile, ku forcat janë të vendosur jashtë territorit të Republikës së Kosovës

8. Kontratat e lidhura nga organet shtetërore ose njësitë e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës me organet shtetërore ose organet e autoriteteve lokale të një shteti tjetër, dhe në lidhje me furnizimin e pajisjeve ushtarake apo pajisjeve të ndjeshme

Për zbatimin e paragrafëve 4, 5 dhe 8, vendos Autoriteti Kontraktues dhe për këtë paraprakisht e njofton Kryeministrin e Republikës së Kosovës.

Pra, nuk ka qenë dhe nuk është identiteti i autoritetit kontraktues ai që përcakton nëse prokurimi do të përjashtohet ose jo nga rregullat e prokurimit. Përrjashtimi nuk jepet sepse është Ministria e Mbrojtjes ajo që po e kryen prokurimin;

Përrjashtimi zbatohet vetëm për subjektin e prokurimit, d.m.th. për produktet me karakter ushtarak.

Neni 4 Përkufizimet

- Ne mënyre që LPP të jete në përputhje me Direktivën e RE të BE-se, 2014/24/EU, me LPP e ri është zëvendësuar procedura e negociuar pas publikimit me procedure konkurruese me negociata. Si rrjedhojë e këtij ndryshimi është amendamentuar përkufizimi 1.4 “Kandidat” dhe 1.35 “Procedura e negociuar”

1.4. **Kandidat** - një operator ekonomik që ka kërkuar të ftohet ose është ftuar të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit që është duke u ushtruar **me procedurë të kufizuar, të negociuar pa publikim ose procedurë konkurruese me negociata** (për arsye të prezantimit të procedurës së re. Procedura e re shtjellohet me vone)

1.43 “Zyrtari i prokurimit”. **Është fshire fjala drejtor i Departamentit që do të thotë se nuk ka nevojë që në një autoritet i vogël të themelohet Departamenti i prokurimit.**

1.19 “Operator Ekonomik”. **Është shtuar fjala Organizata e shoqërisë civile që do të thotë se edhe OSHC mund të konkurrojnë në aktivitetet të prokurimit.**

Neni 4

Përkufizimet (2)

1.74 “Konflikti i interesit” ne zbatim te nenit 24 te Direktivës 2014/24 / EC. Ky përkufizim ndërlidhet me nenin 65 qe do te thotë se **OE kur te nënshkruajnë Deklaratën nen Betim do te deklarojnë se nuk kane konflikt te interesit.**

“Konfliktet e interesit - çdo situatë ku anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit”.

Neni 10

Mjetet për promovimin e Transparencës

Paragrafit 1 i shtohet ky pasues. *“Ruajtja e dokumenteve përkatëse bëhet sipas legjislacionit në fuqi për Arkivat Shtetërore”.*

Ndryshohet paragrafi 3 dhe 5.

Fjala **person** zëvendësohet me fjalën **pala e interesit** dmth vetëm pala e interesit mund të kërkoj qasje ne dokumentacion.

Pala e interesit, ne përputhje me nenin 4.1.26, është *personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.*

Neni 21

Kufizimet për zbatimin e Neneve 16-20

- **Fshihet paragrafi 2 i nenit 21**
- **Me LPP bazik vlera e parashikuar e kontratës është konsideruar konfidencial.**
- **Me amendamentim vlera e parashikuar e kontratave nuk është konfidencial dhe mund te publikohet ne Njoftimin për kontrate.**

Neni 21/A Ekonomizimi i aktivitetit të prokurimit

Shtohet neni i ri 21/A

- Për qëllime të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministritë përkatëse kryejnë procedurat e prokurimit të Agjencive të pavarura që i përgjigjen atyre, të cilat kanë më pak se 50 punonjës **p.sh. MF kryen prokurimet për AQP, Kuvendi për KRPP, OSHP etj pasi qe kane me pak se 50 punonjës.**
- **Ne raste specifike KRPP aprovon një kërkesë të një AK që ai AK të zhvillojë vetë procedurat.**

Neni 23

Zyrtarët e Prokurimit

Behet dallimi ne mes te zyrtarit përgjegjës te prokurimit dhe zyrtarit te prokurimit

3. Asnjë person nuk mund të shërbej **si Zyrtar i Prokurimit** apo si anëtar i stafit të njësisë së prokurimit ...

Zëvendësohet me

3. Asnjë person nuk mund të shërbej **si Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit**

Neni 24

Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Ndryshohet paragrafi 4.

Behet dallimi ne mes te zyrtarit përgjegjës te prokurimit dhe zyrtarit te prokurimit. (Zyrtari i prokurimit është punonjës i njësisë së Prokurimit ndërsa zyrtari përgjegjës i Prokurimit është Menaxheri i Prokurimit.)

Neni 25

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit

Përgjegjësitë për trajnime barten nga IKAP tek KRPP

KRPP:

- **Zhvillon modulet e trajnimit dhe kurrikulen**
- **Identifikon (përzgjedh) trajnerët**
- **Siguron qe trajnimet te mbahen nga trajnerë apo Institucion i trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikat më të mira ndërkombëtare të prokurimit; dhe në sistemin e prokurimit të BE-së**
- **Ne bashkëpunim me IKAP-in aranzhon zhvillimin dhe mbajtjen e trajnimeve**
 - ✓ 15 dite trajnime bazike
 - ✓ 10 dite trajnime te avancuara
- **Ne bashkëpunim me IKAP-in është përgjegjës për organizimin e provimeve.**
- **Në bashkëpunim me IKAP-in lëshon “certifikatën themelore profesionale të prokurimit” dhe “certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit.**

Neni 25

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit (2)

Certifikatat:

- Certifikatat themelore profesionale të prokurimit janë të **vlefshme për tri (3) vite**
- Personi i cili mban një certifikatë themelore të prokurimit dhe i cili nuk arrin të marrë certifikatën e avancuar **brenda kësaj periudhe tri (3) vjeçare e humb të drejtën për të shërbyer si Zyrtar përgjegjës i Prokurimit** përderisa ai/ajo të marrë certifikatën e avancuar
- **Certifikatat e avancuara kanë validitet të përhershëm dhe në rast se KRPP-ja organizon trajnime bartësit e tyre janë të obliguar që të ndjekin trajnimet**
- Personat të cilët posedojnë një **certifikatë ose diplomë të avancuar të nivelit bachelor ose master të prokurimit** të njohur ndërkombëtarësh **janë të përjashtuar nga obligimi për certifikim**. Megjithatë, këta persona janë të obliguar që të marrin pjesë në **trajnimin e vazhdueshëm**.

Neni 25

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit (3)

- ✓ **Certifikatë ose diplomë e avancuar konsiderohen, një certifikatë ose diplomë e avancuar, të cilën e disponon një kandidat, dhe e cila është fituar në një institucion të licencuar arsimor, brenda apo jashtë Kosovës, nëse programi arsimor është i bazuar në Direktivat e Prokurimit të KE, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare, të ketë zgjatur minimum pesëmbëdhjetë (15) ditë, si dhe në fund kandidati ti jetë nënshtruar provimit dhe me sukses ta ketë përfunduar atë**
- ✓ **Diplomë bachelor ose master e prokurimit publik konsiderohet ajo diplomë e cila është fituar në një institucion të licencuar arsimor brenda apo jashtë Kosovës, dhe që i përket drejtimit të prokurimit publik.**

Neni 25

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit (4)

Pjesëmarrja:

- **Çdo person mund të marrë pjesë në kurset profesionale** të trajnimit në prokurim të organizuara nga **KRPP-ja dhe IKAP-** nëse ka hapësirë të mjaftueshme pas akomodimit të Zyrtarëve të Prokurimit dhe punonjësve të njësive të Prokurimit
- **KRPP-ja mund të vendosë një tarifë të arsyeshme** për pjesëmarrje për personat që marrin pjesë në këto kurse. *(nuk vlen për Zyrtarët përgjegjës të Prokurimit, punonjësit e njësive të Prokurimit ose nëpunësit civil)*
- **KRPP-ja do ti sigurojë një kopje të materialeve të trajnimit çdo personi** të interesuar i cili duhet të paguajë një tarifë të arsyeshme për mbulimin e shpenzimeve të kopjimit *(nuk vlen për Zyrtarët përgjegjës të Prokurimit, punonjësit e njësive të Prokurimit ose nëpunësit civil).*

Neni 25

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit (5)

Anulimi i certifikatës

- Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga **KRPP-ja ose IKAP-i** mund të **anulohet nga KRPP-ja** (me LPP bazik nga OSHP-ja ndërsa me LPP e ri nga KRPP-ja)
- Nëse poseduesi i certifikatës **është nëpunës civil**, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e **Ligjit për Shërbimin Civil**
- Nëse poseduesi i certifikatës **nuk është nëpunës civil**, KRPP-ja duhet **ti dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej 90 ditëve** për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të **drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative.**
- Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës personi në fjalë është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në **Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative**
- **Pas periudhës një vjeçare zyrtari në fjalë mund të filloj trajnimin bazik.**

Neni 25

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit

Shtohen paragrafët 10 -12.

- **KRPP-ja dhe IKAP-i do të hartojnë një rregullore për funksionimin në lidhje për trajnimin në prokurim publik.**
- **Të gjithë zyrtarët të prokurimit duhet të kryejnë programet e trajnimit dhe të certifikohen në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe vendimet përkatëse të KRPP-së deri më 31.12.2016.**
- **Të gjitha certifikatat ekzistuese të mbajtura nga zyrtarët të prokurimit janë valide deri më 31.12.2016.**

Neni 26

Nënshkrimi i kontratave publike

- Shtohet një fjali pas nenit 1 për **nënshkrim te kontratave me vlera minimale (1000) nga drejtoret e shkollave.**

Përfundimisht, për kontratat me vlera minimale që zhvillohen në Institucionet arsimore, në pajtim me nenin 19 paragrafi 4 të këtij ligji, person i autorizuar të nënshkruaj një kontratë është Drejtori i Institucionit Arsimor

- Shtohet një fjali ne nenit 2 me te cilët **përfundimisht Presidenti, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri** nga obligimi i nënshkrimit te kontratës.
- Shtohet një fjali ne nenit 3 me te cilët përfundimisht **Ministri i Financave** nga obligimi i nënshkrimit te kontratave te konkluduara nga AQP.

Neni 27

Dosja e Tenderit

- Shtohet një fjali ne nenit 1 ku largohet kërkesa **qe DT te përmbaj edhe Njoftimin për kontrate.**

Te gjitha kërkesat e Njoftimit për kontrate janë te përcaktuara ne Fletën e te Dhënave kështu qe është konsideruar se nuk ka nevojë qe DT te përmbaj edhe Njoftimin për kontrate.

- Shtohet një fjali ne nenit 4 “*Kërkesat e përcaktuara ne Dosjen e tenderit dhe ne Njoftimin për kontrate duhet te jene identike*” [për arsye se shumë shpesh është konstatuar se ka pasur mospërputhje ne mes DT dhe Njoftimit për kontrate dhe ka lind pyetja se cila kërkesë mbizotëron.

Kjo mospërputhje do te eliminohet gjithashtu me e-prokurimin sepse ne momentin qe një AK përgatite DT sistemi krijon automatikisht Njoftimin për kontrate.

Neni 27/A - Ndarja e kontratave në Lote

- Në mënyrë që të nxitet përfshirja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në tregun kombëtar të prokurimit publik, autoritetet kontraktuese duhet të **inkurajohen që te ndajnë kontratat ne lote**
- Kur kontratat ndahen në lote, këshillohet që të sigurohet që autoritetet kontraktuese mund, për shembull, në mënyrë që të ruajnë konkurrencën ose që te ofrojnë më shumë mundësi për më shumë operatorë ekonomikë, **të kufizojë numrin e loteve për të cilat një operator ekonomik mund të dorëzojë një tender.**

Neni 27/A - Ndarja e kontratave në Lote (2)

Ky nen përcakton se:

- ✓ Kontratat publike mund të **ndahen në lote homogjene apo heterogjene.**
- ✓ Autoritetet kontraktuese duhet të tregojnë, në njoftimin e kontratës, **nëse tenderuesit mund te konkurrojnë në një ose më shumë lote.**
- ✓ Autoritetet kontraktuese munden, **edhe atëherë kur është përcaktuar mundësia për të tenderuar në të gjitha lotet, të kufizojnë numrin e loteve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues.** Mirëpo **numri maksimal per lotet** te cilat do te shpërblehet duhet të përcaktohet në njoftimin e kontratës.

Neni 28

Specifikimet teknike

Shtohet paragrafi 10 - Inkorporimi i UA 01/2014

- **Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, te cilat janë pjese te dosjes se tenderit.**
- **Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet qe të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.**

Neni 30

Nën-kontraktimi

Ne zbatim te nenit 71 te Direktivës 2014/24 / EC shtohet një fjali ku prezantohet

- Mundësia për **pagese te drejtpërdrejtë të autoritetit kontraktues tek nënkontraktorët për kryerjen e punëve që rrjedhin nga nënkontrata**, të përcaktuar në kuadër të kontratës kryesore.
- Kjo do ti ofroje nënkontraktoreve (normalisht NVM-të) një mbrojtje efektive kundër rrezikut të mos-pagesën ose pagesa te vonuara.

Neni 31

Ekzekutimi i kontratave

Shtohet paragrafi 2 - Inkorporimi i UA 04/2015

Autoriteti kontraktues mund të vendosë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh, si në vijim:

- Detyrim për të **rekrutuar persona të papunë**, dhe në veçanti **persona të cilët nuk janë në punë për një periudhë të gjatë**;
- Detyrim për të **rekrutuar persona të hendikepuar dhe me aftësi të kufizuar**;
- Për të **themeluar programe trajnimi për të papunët apo për të rinjtë gjatë zbatimit të kontratës**;
- Detyrim për të **zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë projektuar për të nxitur barazinë gjinore apo diversitetit mbi baza të tjera**; apo
- Detyrim për të qenë në **përputhje me substancën e dispozitave të konventave themelore të ILO-së gjatë ekzekutimit të kontratës**, nëse këto dispozita nuk janë zbatuar në ligjin respektiv.

Neni 32

Rregullat e Përgjithshme

Fshihen paragrafi 4 dhe 5 qe do te thotë se AK mund te vazhdoj me një tender te përgjegjshëm.

Neni 34

Procedura konkurruese me negociata

Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC)

- **Procedura e re konkurruese me negociata** zëvendëson procedurën aktuale procedurën e negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës.
- Përdorimi i kësaj procedure rekomandohet në situata të ndryshme ku:
 - ✓ **procedurat e hapura ose të kufizuara nuk mund të shpënë në rezultate të kënaqshme të prokurimit:**
 - ✓ si në rastin e **blerjeve komplekse** të tilla si produkte të sofistikuara, **shërbime intelektuale** (për shembull disa shërbime të konsulencës, shërbimet arkitektonike ose shërbimet inxhinierike), dhe të komunikimit të teknologjisë ,
 - ✓ **punët e ndërtesave jo standarde ose që përfshijnë dizajn apo zgjidhje të reja.**

Neni 34

Procedura konkurruese me negociata (2)

- Në këto raste, negociatat mund të jenë të nevojshme për të garantuar se furnizimi, puna ose shërbimi në fjalë korrespondon me nevojat e autoritetit kontraktues.
- Procedura përfshin që OE në përgjigje të një **ftesë dorëzojnë një ofertë fillestare e cila negociohet dhe rregullohet ne mënyre progresive nga AK**, deri në tenderin përfundimtar)

Neni 34

Procedura konkurruese me negociata (3)

- Në këto raste, negociatat mund të jenë të nevojshme për të garantuar se furnizimi, puna ose shërbimi në fjalë korrespondon me nevojat e autoritetit kontraktues.
- Procedura përfshin që OE në përgjigje të një **ftesë dorëzojnë një ofertë fillestare e cila negociohet dhe rregullohet ne mënyre progresive nga AK**, deri në tenderin përfundimtar)

Neni 34

Procedura konkurruese me negociata (4)

- Udhëhiqet përmes **3 fazave**
- **faza e pare - parakualifikimit** – 10 dite nga momenti i publikimit
- **faza e dyte - faza e tenderimit** – 20 dite nga data e dorëzimit të DT (tenderi fillestar)
- **faza e trete – negociojnë me ofertuesit tenderët fillestar** dhe të gjithë tenderët pasues të dorëzuar me përjashtim të tenderëve përfundimtar (**afati kohor për tender përfundimtar përcaktohet nga AK**)
-
- AK duhet të përcaktoj **numrin minimal (3)** dhe **numrin maksimal (6)** në përputhje me nenin 56 të LPP) të OE që do të kualifikohen
- **Kërkesat minimale dhe kriteret e dhënies nuk janë subjekt i negociatave**

Neni 34

Procedura konkurruese me negociata (5)

Shpërblimi

- Autoritetet kontraktuese mund te shpërblejnë **kontratat në bazë të tenderëve fillestare pa negociata**, ku ata kanë përcaktuar këtë në njoftimin e kontratës
- Autoritetet kontraktuese mund te shpërblejnë kontratat **vetëm pas negociatave dhe pas dorëzimit te tenderit përfundimtar**, ku ata kanë përcaktuar këtë në njoftimin e kontratës

Neni 35

Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

Riformulim shtohet

“në përputhje me nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.3 të këtij ligji”

Neni 36

Procedurat për kuotimin e çmimeve

Ndryshohet ky nen

- **Njoftimi për kontrate me amendamentim publikohet edhe për procedurën e kuotimit të çmimit**
- **Vazhdohet me një kuotim të përgjegjshëm**

Neni 38

Kontratat Publike Kornizë

Shtohet një fjali ne paragrafin 2 ne zbatim te UA 02/2015

- Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. **Dmth nëse kontrata lidhet për 24 muaj nuk mund te vazhdohet edhe për 12 muaj (nuk lejohen opsionet)**
- **Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative (lejohet plus/minus tridhjetë përqind (30%) devijim)**
- **Nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%) pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.**

Neni 38

Kontratat Publike Kornizë (2)

Mini tenderimi

- Autoriteti kontraktues i fton të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë palë të kontratës publike kornizë që të paraqesin ofertat e tyre me shkrim
- **Në rast se jo të gjithë Operatorët Ekonomikë që janë palë të Kontratës Publike kornize dorëzojnë ofertat e tyre, procedura e mini-tenderimit do të jetë e vlefshme**

Neni 40

Njoftimi i Kontratës

Si rrjedhoje e ndryshimeve të mësipërme

- prezantimi i procedurës së re (procedura konkurruese me negociata) dhe
- publikimi i njoftimit për kontratë edhe për kuotime,

është riformuluar ky nen

*Nëse autoriteti kontraktues ka dhënë një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, **konkurruese me negociata, e negociuara pa publikim**, ose procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas dhënies së kontratës së tillë...*

Neni 41

Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës

Si rrjedhoje e ndryshimeve te mësipërme

- **prezantimi i procedurës se re (procedura konkurruese me negociata) është riformuluar ky nen**

*Kur një autoritet kontraktues synon që të ndërmarrë prokurimin duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara, **kuotim te cmimit ose konkurruese me negociata** , autoriteti kontraktues do të përgatisë*

Si dhe si rezultat i inkorporimit te UA 03/2014 është shtuar fjalia:

Autoriteti kontraktues, se bashku me Njoftimin për dhënie te kontratës, duhet te dorëzoj ne KRPP një kopje te deklaratës se Nevojave dhe Disponueshmerise se mjeteve për kontratën e shpërblyer

Neni 41/A

Njoftimi për nënshkrimin e kontratës

Është prezantuar një Dispozite e re Neni 41/A - **Njoftimi për nënshkrimin e kontratës** për nevoja te KRPP-se.

- Publikimi i njoftimit për dhënie te kontratës nuk determinon numrin e sakte te kontratave te nënshkruara pasi qe ai njoftim mund te anulohet nga OSHP apo KRPP.
- Prandaj AK pas nënshkrimi te një kontrate duhet te dorëzojnë ne KRPP për publikim një Njoftim për Nënshkrim te kontratës.

Neni 42

Publikimi i njoftimeve

- **Është ndryshuar paragrafi 1 si rrjedhojë e prezantimit të dispozitës së re Neni 41a Njoftimi për nënshkrimin e kontratës**

 - **Është fshire paragrafi 3 sepse njoftimi për dhënie të kontratës publikohet në webfaqen e KRPP-së si dhe të gjithë OE u dërgohet Njoftimi mbi eliminim në përputhje me nenin 54 të LPP-së**
3. *Autoriteti kontraktues do t'u dërgojë njoftimin për dhënien e kontratës, menjëherë pasi që ky të përgatitet, të gjitha operatorëve ekonomik që kanë tenderuar. Autoriteti kontraktues do t'u dërgojë operatorëve ekonomik njoftimin në fjalë, përmes mjeteve më të shpejta në dispozicion.*

Neni 44

Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje

Si rrjedhojë e prezantimit të dispozitës së re Neni 34 – Procedura konkurruese me negociata (Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC) është fshire paragrafi 4.

4. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurat e negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve që është:...

Afatet kohore për këtë procedure rregullohen në nenin 34

Neni 46
Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve
kohore

Është ndryshuar paragrafi 3 si rrjedhojë e prezantimit të dispozitës së re Neni 34 (Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC)

*3. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdor **procedurat e kufizuara ose të negociuara**, autoriteti kontraktues ...*

ne

*3. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdor **procedurat e kufizuara**, autoriteti kontraktues*

Neni 47

Fillimi i Afatit Kohor për Pranimin Kërkesave për Pjesëmarrje dhe Tenderëve

Si rrjedhoje e ndryshimeve të mësipërme (prezantimi i procedurës së re dhe publikimi i njoftimit edhe për kuotime) (Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC) janë riformuluar nen-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3

1.1 për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdor procedurat e hapura ose procedurat e kuotimit të çmimeve, **në datën e publikimit të njoftimit të kontratës;**

1.2 për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që përdor procedurat e kufizuara ose procedurat konkurruese me negociata, në **datën e publikimit të njoftimit të kontratës;**

1.3. për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdor procedurat e kufizuara ose procedurat konkurruese me negociata, **në datën kur të gjitha ftesat për dorëzimin e tenderit janë dërguar.**

Neni 50

Dërgimi dhe Përmbajtja e Ftesave për Tender

Si rrjedhoje e ndryshimeve të mësipërme (prezantimi i procedurës së re dhe publikimi i njoftimit edhe për kuotime) (Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC) janë riformuluar paragrafët 1, 2 dhe 4 dhe është fshirë paragrafi 3

3. Gjatë procedurave të kuotimit të çmimeve, ftesa për tenderim duhet të përmbajë të gjitha informacionet materiale që u nevojiten kandidatëve për të dorëzuar kuota të përgjegjshme të çmimeve.

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Si rrjedhojë e ndryshimeve të mësipërme (prezantimi i procedurës së re dhe publikimi i njoftimit edhe për kuotime) (Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC) është riformuluar paragrafi 1

*1. Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet të përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura **dhe procedurave të kuotimit të çmimit** për dhënien e një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara **ose procedurave konkurruese me negociata,***

...

Neni 52

Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Shtohet paragrafi 5 dhe 6 ne zbatim te UA 03/2015

- Në rast të **kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm** është e detyrueshme që të konvertohet **çdo element i kriterëve të dhënies në pike dhe me pas të peshohet në bazë të formulës**
- Në rast të **kriterit tenderi me çmimin më të ulët nuk** lejohet konvertimi i **çmimeve në pike dhe të peshohen piket.**
- Në rast të **kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në baze të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull"**
- Në rast të **çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuar bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen piket duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.**
- **Rreptësishtë ndalohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pike.**

Neni 52
Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës (2)

Paragrafi 7 shtohet ne Zbatim te nenit 67.4 të Direktivës 2014/24 / EC)

Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.

Neni 53

Sigurimi i informatave shtese për kandidatët dhe tenderuesit

Si rrjedhoje e prezantimit te dispozitës se re Neni 34 (Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC)

*Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose **konkurruese me negociata**, autoriteti kontraktues u jep informata...*

Neni 56

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Shtohet fjalia ne paragrafin 2.2

Autoriteti kontraktues duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dokumentet e parakualifikimit (i) informatat të cilat do të formojnë bazën për përzgjedhjen e kandidatëve (ii) kriteret objektive dhe jo-diskriminuese që do të merren parasysh gjatë procedurës së përzgjedhjes dhe peshën që i është dhënë secilit kriter.

Neni 57

Sigurimi i Tenderit

- Me Ligjin bazik shuma e sigurisë është dashur të jetë jo më pak se **tri përqind (3%)** dhe jo më shumë se **pesë përqind (5%)** e vlerës së parashikuar të kontratës
- Zvogëlohet shuma e sigurisë se tenderit nga **min 1% dhe jo me shume se 3 %**
- Me ndryshimin e paragrafit 5 përcaktohet se Sigurimi i tenderit mund të dorëzohet edhe nga **Kompanitë e sigurimeve** si dhe nuk mund të dorëzohen ne para te gatshme.
- Si rezultat i Inkorporimit te UA 02/2014 është riformuluar paragrafi 6 qe përcakton se është OE ai i cili vendos se ne cilën forme te dorëzoj sigurimin e tenderit.

Neni 58

Hapja e Tenderëve

- **Ligji bazik e ka miratuar rregullin për gabimet aritmetike (në legjislacionin dytësor) duke siguruar kriterin e mbizotërimit të çmimit për njësi mbi totalin si rregull që aplikohet për të korigjuar gabimet e tilla.**
- **Rregull i tillë, në praktikë me dashje është keqpërdorur nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik në mënyrë që të ndryshojnë tenderët në mënyrë korruptive.**

Neni 58

Hapja e Tenderëve (2)

- Në mënyrë që të shmanget qasja e tillë e paligjshme është amandamantuar ky paragrafi 3 i këtij neni i cili përcakton që gjate hapjes publike ZP lexon:
 - ✓ emrin dhe vendin e tenderuesit,
 - ✓ çmimin e përgjithshëm të tenderit të specifikuar në tenderin e tillë dhe, kurdo që është e mundur, **çmimet për njësi**, përveç kur dokumenti përkatës është vetëm komponenti i propozimit teknik të tenderit dypjesësh, dhe
 - ✓ ndonjë vërejtje

Neni 58

Hapja e Tenderëve (3)

- Kur për arsye të jo atypëratyshme çmimet për njësi **nuk mund të lexon**, çmimet e tilla në çdo rast **duhet të bëhen të dukshme gjatë hapjes publike** për të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, si për shembull duke bërë **postimin e tyre ose duke përdorur ndonjë tjetër metode adekuate e cila garanton transparence**
- Në çdo rast, secila faqe e çdo tenderi financiar do të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër
- **Ne rast të aktivitetit të prokurimit ku kriter i shpërblimit të kontratës është tenderi ekonomikisht më i favorshëm çdo gjë që ka të bëjë me numra** duhet të lexohet si afati i dërgesës, periudha e garancionit etj

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

- **Ne nenin 59 paragrafin 1 është shtuar fjalia mbi përgjegjësinë e Komisionit të Vlerësimit**

- *Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.*

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (2)

- Ne nenin 59 paragrafin 3 është shtuar fjalia që **nuk lejon përmirësimin e gabimeve aritmetike nëse gabimi është me shume se 2% i vlerës totale te ofertës.**
- Dhe gjithashtu është sqaruar se në rast të gabimeve aritmetike **çmimi për njësi i ofertuar** nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si **çmim mbizotërues** mbi çdo çmim tjetër kontradiktor.

Neni 60.A
LIGJI NR. 04/L -237

- **LPP ishte amendamentuar me ligjin nr. 04/L-237 - Përparësia për Ofertuesit Vendor**
- **Preferenca për Kompani vendore është në kundërshtim me nenin 23, paragrafët 2 dhe 8, të Direktivës EC 2004/18/EC mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave publike për punë, kontratave publike për furnizime dhe kontratave publike për shërbime prandaj është fshire ky nen.**
- **Nuk ka preference për kompanitë vendore.**

Neni 61

Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

- Shtohet paragrafi i ri 6 ne lidhje me çmimin jo-normalisht të ulët.
- Me këtë nen **KRPP duhet të nxjerr akt nënligjor për rregullimin në hollësi për përcaktimin e çmimit jo-normalisht të ulët. (ndoshta do të merr parasysh formulën e propozuar të Direktivës)**
- Në përputhje me Propozimin e Direktivës së re të BE-së në fushën e prokurimit publik, metoda e propozuar matematikore është e bazuar në mesataren e çmimeve të të gjitha ofertave të përgjegjshme. Çmimi i tillë duhet të pasqyrojë çmimin e tregut të besueshme. Kështu, një tender do të konsiderohet jo-normalisht i ulët, kurdo që përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - (a) çmimi i ofruar është më shumë se 50 % më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të mbetur;
 - (b) çmimi i ofruar është më shumë se 20% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
 - (c) të paktën pesë tenderë janë dorëzuar.

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Autoriteti kontraktues **mund të përfundojë** atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në mënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimi

të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë enevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit

Autoriteti kontraktues **duhet të përfundojë** aktivitet të prokurimit për shkaqet e përcaktuara ne **paragrafin 1.1** ndërsa **mund të përfundoj** për shkaqet e përcaktuar ne **paragrafët 1.2 dhe 1.3**

Për me tepër AK mund te përfundoj aktivitetin e prokurimit **PARA Hapjes** - **por kjo duhet të bëhet së paku tre ditë para hapjes së tenderëve** – pra jo ne ditën e fundit!

Neni 63

Siguria e Ekzekutimit

- Me ligjin bazik kërkesa për dorëzim të sigurimit të ekzekutimit të kontratës , për kontrata me vlerë të mesme dhe të mëdha, **ka qene obligative.**

- Me këtë amendamentim është riformuluar paragrafi 1 dhe 3 dhe sipas këtij riformulimi mbetet në diskrecion të AK të vendos kërkesën për siguri të ekzekutimit - **nuk është obligative.**

- Si rezultat i Inkorporimit të UA 02/2014 është riformuluar paragrafi 6 që përcakton se është OE ai i cili vendos se në cilën formë të dorëzojë sigurimin e ekzekutimit.

Neni 65

Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Si rrjedhojë e shtimit të përkufizimit të ri “Konflikti i interesit” (në zbatim të nenit 24 të Direktivës 2014/24 / EC) është shtuar pika 1.3:

•OE nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

1. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit
2. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit
3. **duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 1.75**

Paragrafi 3.2. është ndryshuar ne me se vijon:

3.2 është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndë profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente.

Neni 65

Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve (2)

Paragrafi 4.11. është ndryshuar ne me se vijon:

4.11 ka dhënë deklaratë të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes

Neni 66

Përshtatshmëria Profesionale

Si rezultat i amendamentimit të përkufizimit 1.19 “Operator Ekonomik”.

Operator ekonomik - term i përgjithshëm që përfshinë furnizuesin, ofruesin e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve. Për qëllim të këtij ligji, edhe **organizatat e shoqërisë civile konsiderohen operator ekonomik**

Është amendamentuar edhe ky nen ku është shtuar fjalia se nuk kërkohet Certifikata e Biznesit për Organizatat e Shoqërisë Civile.

Neni 68

Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Ne zbatim te nenit 58 te Direktivës 2014/24 / EC është amendamentuar paragrafi 1 i cili përcakton”

- qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet te kenë nuk do të kalojë **dy herë vlerën e parashikuar të kontratës**
- Kërkesat mbi gjendjen ekonomike **duhet te shprehen detyrimisht ne shifra** dhe do ti referohen maksimum **tri viteve te fundit financiare** (*shpesh është kërkuar qe qarkullimi te jete sa dyfishi i vlerës se ofertës dhe ne shumicën e rasteve kjo kërkesë nuk ka qene e njëjte për te gjithë OE sepse nëse vlera e ofertës se një OE është 500 000 Euro ai OE është dashur qe te ketë qarkullim 1 000 000 Euro ndërsa OE oferta e te cilit ka qene 750 000 është dashur te ketë qarkullim 1 500 000 Euro)*
- Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal ne fushën specifike te mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tille nuk duhet te tejkalojë **1.5 here vlerën e parashikuar te kontratës.**

Neni 68

Gjendja Ekonomike dhe Financiare (2)

Dëshmitë te cilat lejohen për tu dorëzuar për te gjendjen ekonomike janë shtuar. Pra lejohet edhe

- raportet e lëshuara nga një auditor i licencuar i pavarur; dhe**
- Deklaratat tatimore Vjetore te dorëzuara ne ATK**

Neni 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Është riformuluar paragrafi 2.4. është fshire

*mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen, **autenticitetit dhe cilësisë reprezentuese e cila duhet të vërtetohet nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues;***

Neni 71

Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

- **Sipas LPP bazik kërkesat e nenit 66 (certifikata e biznesit dhe Licenca/Autorizimi) është dashur që të plotësohen nga grupi në tërësi.**
- **Me këtë ndryshim certifikata e biznesit duhet të plotësohet nga secili anëtar i grupit ndërsa kërkesa për licence/autorizim plotësohet vetëm nga njëri anëtar i Grupit të OE.**

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Riformulim i Nenit 72

- Autoriteti kontraktues **mund**, me shkrim, të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të ndihmojë në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.
- Me fjalë të tjera, lejohet që një autoritet kontraktues **gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacionin fillestar**. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të **prezantojnë se kanë ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të aplikacionit apo të dorëzimit të tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive**.

Neni 83

Ftesa për tender me anë të Njoftimit Paraprak

Si rrjedhojë e prezantimit të dispozitës së re Neni 34 – Procedura konkurruese me negociata (Zbatimi i nenit 29 të Direktivës 2014/24 / EC)

*Njoftimet për kontratë që ftojnë pjesëmarrësit në procedura të kufizuar ose në **procedura të negociuara pas publikimit të njoftimit për kontratë** mund të zëvendësohen...*

Ne

- *Njoftimet për kontratë që ftojnë pjesëmarrësit në procedura të kufizuar ose në **procedura konkurruese me negociata** mund zëvendësohen...*

Neni 87

Funksionet Themelore të KRPP-së

Ndryshohen kompetencat e KRPP-se

2.1 të kryej **hetimet** ndryshohet ne të kryej **monitorimet**

2.2 të lëshoj një urdhëresë që kërkon nga zyrtarët e zbatimit të ligjit të asistojnë KRPP-në që të sigurojnë përputhshmërinë me një urdhëresë tjetër të KRPP-së – **është fshire**

2.4 parashihte që KRPP-ja **duhet të ekzaminoj raportet e dërguara** nga autoritetet kontraktuese në lidhje me anulimin e procedurës së tenderimit kur pranohet vetëm një tender (neni 32) dhe raportet e dërguara në lidhje me procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës (neni 35) ndryshohet ne **te pranoj raportet nga autoritetet kontraktuese siç referohet ne nenin 35, paragrafi 1 dhe nenin 61, paragrafi 5, te këtij ligji.**

Neni 87

Funksionet Themelore të KRPP-së (2)

Zgjidhja e ofruar është:

- **Autoritetet kontraktuese që shpërblejnë kontrata në mënyre të drejtpërdrejte në përputhje me nenin 35.1, dhe kurdo që refuzojnë një oferte me çmime jonormalisht të ulte, AK do t'i komunikojnë vendimet e tilla tek KRPP-ja e cila do të përdore raportet e lartpërmendura për funksionet e saj siç referohet në nenin 87.2.12 dhe neni 87.2.13.**
- **KRPP-ja mund të vendos që të kryej kontrole të këtyre vendimeve, duke i ftuar, kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese që kanë marr vendimet përkatës për të shqyrtuar vendimin e tyre.**
- **Opinionet e lëshuar nga KRPP-ja nuk ka një karakter të detyrueshëm për autoritetet kontraktuese të cilat nuk janë të detyruara të pajtohen me mendimin e KRPP-së.**
- **Opinionet e lartpërmendura në çdo rast mund të marrin në konsideratë nga OSHP-ja gjatë trajtimit të një ankesë lidhur me vendimin në fjalë.**

Neni 88
Funksionet e Vëzhgimit dhe të Mbikëqyrjes të KRPP-së

Prezantohet pozita ekspert i prokurimit për stafin e KRPP-se

Neni 89

Emërimi i Anëtarëve

- **Me amendamentimin e paragrafit 1 te këtij neni anëtarët e bordit te KRPP-se **nuk mund te rëmërohen** si dhe ne mënyre qe te mos ndërpritet funksionimi i KRPP-se anëtarët e bordit, pas skadimit te emërimit prej 5 vitesh, vazhdojnë mandatin deri sa te zgjedhën anëtarët e riye.**

- **Me amendamentimin e paragrafit 4 te këtij neni anëtarët e bordit te KRPP-se duhet te të përmbushin kushtet si në vijim:**
 1. të ketë diplomë universitare;
 2. së paku pesë (5)vjet përvojë në fushën e financave publike dhe në fushën e prokurimit.

Neni 93

Pezullimi dhe suspendimi i anëtarëve të KRPP-së

- **Me LPP bazik nëse** Qeveria apo Kuvendi, kane konsideruar se ka arsye për largimin e një anëtari të KRPP, ata kane mundur të paraqesin çështjen për vendim **në gjykatën kompetente, duke dhënë arsye** që e vërtetojnë këtë dhe të gjitha dokumentet e **provave të kërkuara** nga gjykata.
- **Me amendamentimin e këtij neni një anëtar i bordit të KRPP-se suspendohet apo largohet** nëse i nënshtrohen një procedure gjyqësore në të cilën akuzohen për vepër penale apo nëse ka kryer ndonjë vepër që bie ndesh me etikën profesionale dhe profesionalizimin.
- Mënyra e largimit apo suspendimit është e njëjte me atë të emërimit d.m.th Qeveria i propozon për largim ndërsa Parlamenti aprovon kërkesën e Qeverise.

Neni 94
Agjencia Qendrore e Prokurimit

- **Riformulohet paragrafi 2 për raportim te AQP-se;**
- AQP-ja për çdo vit kalendarik përgatitë dhe i dorëzon ministrit të Financave një raport vjetor
- raporti dorëzohet jo më vonë se në **fund të muajit shkurt** të vitit vijues kalendarik.

Neni 95

Aktivitetet e Prokurimit të AQP

Riformulohet paragrafi 1;

- Ministri i Financave **ka autoritetin** për ta përcaktuar AQP-në si autoritetin kontraktues përgjegjës për kryerjen e atij aktiviteti prokurim
- Në një rast të tillë (i) **AQP njofton autoritetin përkatës kontraktues ose autoritetet**, të cilat nuk janë më të autorizuara të kryejnë prokurimin në fjalë (me LPP bazik Ministri i financave njofton autoritetin përkatës kontraktues ose autoritetet – tani MF përcakton AQP-në si autoritetin kontraktues përgjegjës për kryerjen e atij aktiviteti prokurimi ndërsa AQP e njofton Autoritetin)
- LPP bazik përcaktonte: *Ministri i financave siguron marrëveshjen nga bordi mbikëqyrës përkatës nëse autoriteti kontraktues është ndërmarrje në pronësi publike – është fshire kjo fjali.*

Neni 95

Aktivitetet e Prokurimit të AQP (2)

Riformulohet paragrafi 2;

- Qeveria sipas propozimit të Ministrisë së Financave do të themeloj brenda datës **31 janar** të çdo viti një listë të mallrave ose të artikujve, punëve ose shërbimeve të përdorimit të përbashkët (LPP bazik nuk ka përcaktua afat kohor)

Riformulohet paragrafi 3;

- **Shtohet fjalia - *Për këta artikuj, pune apo shërbime autoriteti kontraktues nuk do të udhëheq ndonjë aktivitet të pavarur të prokurimit*** dmth AK nuk lejohet që të udhëheq një aktivitet të prokurimit për mallrat, punët apo shërbimet e përcaktuara në listën e mallrave, punëve ose shërbimeve të përdorimit të përbashkët: **Çdo kontratë e lidhur në shkelje të këtij paragrafi do të deklarohet si e pavlefshme.**

Neni 95
Aktivitetet e Prokurimit të AQP (3)

Riformulohet paragrafi 4;

- **Shtohet fjalia - *Ministri i Financave, pas shqyrtimit të këtij arsyetimi nga autoriteti kontraktues, mund ti lejojë AQP-së të kryejë atë aktivitet prokurimi*** dmth Bazuar në një arsyetim adekuat, një autoritet kontraktues mund ti kërkojë AQP-së kryerjen e një aktiviteti prokurimi në emër të tij. Ky aktivitet nuk mund te udhëhiqet nga AQP pa aprovimin e Ministrit te financave. Me LPP Bazik nuk është kërkuar aprovimi nga Ministri i Financave.

Neni 100

Emërimi i anëtarëve të OSHP

- **Me amendamentimin e paragrafit 1 te këtij neni anëtalet e bordit te OSHP-se nuk mund te rieröhohen**
- **Me amendamentimin e paragrafit 2 ne mënyre qe te mos ndërpritet funksionimi i OSHP-se anëtalet e bordit, pas skadimit te emërimit prej 5 vitesh, vazhdojnë mandatin deri sa te zgjedhën anëtalet e rije.**

Neni 100

Emërimi i anëtarëve të OSHP

- **Me amendamentimin e paragrafit 1 te këtij neni anëtarët e bordit te OSHP-se nuk mund te rriemërohen**
- **Me amendamentimin e paragrafit 2 ne mënyre qe te mos ndërpritet funksionimi i OSHP-se anëtarët e bordit, pas skadimit te emërimit prej 5 vitesh, vazhdojnë mandatin deri sa te zgjedhën anëtarët e riye.**

Neni 100

Emërimi i anëtarëve të OSHP (2)

Me amendamentimin e paragrafit 4 te këtij neni anëtarët e bordit te OSHP-se duhet te të përmbushin kushtet si në vijim:

4.1. të jetë shtetas i Kosovës;

4.2. të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;

4.3. të ketë diplomë të Fakultetit Juridik që është e vlefshme sipas ligjit në Kosovë;

4.4. të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;

4.5. të ketë së paku tre (3) vjet përvojë profesionale në fushën e drejtësisë që lidhet me administratën publike dhe prokurimin, pas përfundimit të provimit të jurisprudencës;

4.6. të ketë aftësi për të kryer detyrat e postit në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, të zellshme, me vendosmëri dhe përgjegjshmëri, për të cilin ai është duke u konsideruar.

Nenet ne lidhje me emërimin e anëtarëve te Bordit te OSHP-se janë fshire!!!

Neni 102

Suspendimi dhe largimi i anëtarëve të OSHP-së

Me amendamentimin e këtij neni një anëtarë i bordit të OSHP-se suspendohet nëse i nënshtrohen një procedure gjyqësore në të cilën akuzohen për vepër penale.

Si dhe

Nëse një anëtar i OSHP-së është dënuar për ndonjë vepër penale lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në OSHP, largohet nga puna. Nenet në lidhje me largimin e anëtarëve të Bordit të OSHP-se janë fshire!!!

Neni 105

Kompetencat e OSHP-së

OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, që:

2.16 ne rastet e përsëritura me **pretendimet te njëjta** ankimore, kur **objekti i kontestit dhe palët janë te njëjta**, për raste te cilat janë shqyrtuar me pare, kryetari i panelit shqyrtues duhet te trajtoj si çështje te gjykuar *“res judicata”*.

Neni 108a

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Shtohet ky nen

- **Legjislacioni aktual ishte ne përputhje te plote me acquis communautaire, por nevojitej një ndryshim i mëtejme për te qene ne përputhje me legjislacionin e BE-se.**
- Direktiva 2007/66/EC mbi Mjetet Juridike parashikon në nenin 1, paragrafi 5, se “Shtetet Anëtare **mund të kërkojnë që personi në fjalë së pari të kërkojë shqyrtimin pranë nje autoritetit kontraktues**. Në këtë rast, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që paraqitja e një kërkesë të tillë për shqyrtim rezulton në pezullimin e menjëhershëm të mundësisë për lidhje te kontratës”.
- **Qëllimi i dispozitës është për ti vënë autoritetet kontraktuese në një pozicion për ti rishikuar vendimet e tyre dhe, në të njëjtën kohë, për të lehtësuar aksesin në mjetet juridike për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik.**

Neni 108a
Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve (2)

Ankesa

- ✓ Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, , janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit **mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues.**
- ✓ **Ankesa mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera**
- ✓ Dorëzimi i një ankese e obligon **autoritetin kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit**

Neni 108a

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve (3)

Afatet kohore

- ✓ Ankesa duhet të **dorëzohet** tek autoriteti kontraktues, **me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me LPP, brenda afateve të mëposhtme:**
 - në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me **njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;**
 - në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me **vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.**
 - në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me **vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.**

Neni 108a

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve (4)

- ✓ Ankesat duhet të paraqiten **me shkrim** dhe duhet të **përmbajnë të njëjtin informacion dhe dokumente të përcaktuara në nenin 111 paragrafi 1**, me përjashtim të nën-paragrafit 1.9 dhe 1.10.
1.9. e ka të bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes; dhe
1.10. siguron dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit (**nuk ka pagese**
- ✓ Nëse ankesa nuk përmban disa nga informacionet referuar me larte, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësoj kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se **dy (2) ditë** nga marrja e kërkesës. Nëse parashtuesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, **kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë.**
- ✓ Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë ankesën **brenda tre (3) ditë pune** nga data e dorëzimit të ankesës ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë.

Neni 108a
Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve (5)

✓ Ky afat (3 ditor), në raste specifike të justifikuara **mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë**, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ankuesi mund të paraqesë një ankesë **pranë OSHP**.

Neni 108a

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve (6)

Refuzimi i ankesës

- ✓ Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:
 - kërkesa nuk **dorëzohet brenda afateve kohore** ;
 - ankesa **nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi**;
 - ankesa nuk përmban të njëjtin informacion dhe dokumente të përcaktuara në nenin 111 të LPP
 - autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.
- ✓ Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.
- ✓ Autoriteti kontraktues mund të ndal procedurën e mëtejshme, **me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr ankesën.**

Neni 108a
Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve (7)

Vendimi i AK

- ✓ Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:
- ✓ të refuzojë kërkesën e propozuar për **shqyrtim si të pabaze;**
- ✓ të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;

Neni 109

Afatet për Dorëzimin e Ankesës

Ne përputhje me nenin e mësipërm është amendamentuar edhe ky nen i cili përcakton se:

- ✓ Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues, **çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së.**
- ✓ Ankesa **duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes** (dmth fillimisht ankesa të parashtrohet në AK)
- ✓ Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda **dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes**

Neni 111
Arkivimi dhe Përmbajtja Thelbësore e Ankesës

Shtohen nen-paragrafët 1.9 dhe 1.10 dmth ankesës duhet ti bashkëngjitet

- 1.9. një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes (Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshje – parashtrimi i ankesës pran AK);**
dhe
- 1.10. siguron dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit.**

Neni 113
Shqyrtimi fillestar nga eksperti shqyrtues

Riformulohet paragrafi 1 qe nënkupton se eksperti shqyrtues do shqyrtoj të gjitha pretendime e përfshira në ankesë dmth **shqyrton vetëm pikat ankimore dhe jo tere aktivitetin e prokurimit.**

Neni 116

Procedurat e vendim-marrjes

Shtohet paragrafi 6

Ne përputhje me nenin 17.3 te Rregullores se prokurimit publik shtohet paragrafi 6 qe përcakton:

Një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Dmth AK mund te shpërblej prapë te njëjtin OE

Neni 118

Siguria, Gjobat dhe Dëmet

Ndryshimi i paragrafit 1:

- *Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e se cilës do te përcaktohet nga KRPP ne legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vete ankesës ne përputhje me nenin 111 te këtij ligji.*
- Qëllimi i amendamentit te propozuar, është që të ri-proporcionalizohet shuma e tarifave te ankesave qe do te paguhen nga ankuesit dhe qe sistemi i mjeteve juridike te behet me i kapshëm për të gjitha palët e interesuara.
- Ligji bazik përcaktonte një tarifë fikse e cila nuk merrte parasysh vlerën e kontratës. Një dispozitë e tillë duket jo logjike dhe diskriminuese për palët e interesuara të cilat kanë interes në paraqitjen e ankesave për kontratat me vlerë të ulët.

Neni 129

Prokurimi Elektronik

- Me LPP bazik **Qeveria ishte e autorizuar** të nxjerrë rregulla në lidhje me përdorimin e **metodave të prokurimit elektronik** nga autoritetet kontraktuese. Me amendamenti kjo kompetence ka kaluar tek **KRPP**.
- Është amendamentuar paragrafi 4 i cili përcakton:
- ***Përdorimi i prokurimit elektronik është i obligueshëm, në momentin kur Qeveria e Kosovës merr vendim për këtë çështje.***

Neni 132

Prokurimet e Mbyllura në Kundërshtim me Këtë Ligj

- **Fshihet nen-paragrafi 1.3 -1.7 sepse kontratat e nënshkruar mund te shpallen jo-efektive vetëm sipas 2 nen-paragrafëve te pare. Kjo ne përputhje me 2007/66EC.**
- **Pra një kontrate e nënshkruar mund te shpallet jo-efektive nëse:**
 1. është dhënë pa publikimin e mëhershëm të njoftimit kur ishte kërkuar nga ky ligj;
 2. ishte përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontratës;

Neni 132/A
Kontraktimi i shërbimeve nga OSHC

- **Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile.**